

RREGULLORE E ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PROÇEDURAT E NJËSISË BAZË

KREU I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1 Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri” si dhe Statutin e TBU.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat bazë të funksionimit dhe operimit si dhe përgjegjësitë e njësive bazë të Fakultetit Administrim Biznesi dhe Fakultetit të Drejtësisë së TBU.

Neni 3 Fusha e zbatimit

Kjo rregullore është e zbatueshme për të gjitha njësitë bazë të TBU të renditura më poshtë sipas Fakulteteve:

- a. Fakulteti i Administrim Biznesit
 - Departamenti i lëndëve të përgjithshme
 - Departamenti i menaxhimit
 - Departamenti i kontabilitet financës
- b. Fakulteti i Drejtësisë
 - Departamenti i lëndëve të përgjithshme
 - Departamenti i lëndëve profesionale
 - Qendra për kërkime e studime ekonomike dhe juridike

KREU II

DEPARTAMENTI

Neni 4

Funksionet e Departamentit

Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përaferta dhe / ose grupon disiplinat mësimore përkatëse. Departamenti është përgjegjës për programet e studimit që ofron dhe ka funksionet e mëposhtme:

- Nxiti, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore.
- Mbikqyr, promovon dhe orienton përmirësimin dhe ndryshimin e vazhdueshëm të kurikulës për programet e studimit që ofron.
- Në bashkëpunim dhe me departamentet e tjerë organizon dhe zhvillon aktivitete kërkimore dhe shkencore.
- Departamenti propozon programet e reja të studimit, ndryshimet në programet e studimit, numrin e studentëve për çdo program, si dhe nevojat për kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë.
- Departamenti propozon kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi.
- Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren përkatëse për pranimet dhe transferimet.
- Departamenti kryen analizën periodike të programeve të studimit që ofron.
- Kontribuon në hartimin e projekt-akteve që miratohen nga Dekani, Rektori apo Senati përfshi Raportin Vjetor të TBU.
- Departamenti bashkëpunon me organizata të tjera për të mbështetur praktikën, interships dhe punësimin e studentëve.
- Çdo funksion dhe / ose kompetencë që i përcaktohet departamentit nga Statuti i TBU, dhe L-AL në fuqi, të aplikueshme në rastin e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.

Neni 5

Organizimi i Departamentit

Departamentet sipas përcaktimeve të Nenit 3 më lart, janë të organizuar mbi bazën e gruplëndëve që i përkasin disiplinave të njëjta ose të ngjashme. Çdo departament përbëhet nga anëtarët e personelit akademik të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që zhvillojnë kryesisht lëndët që i përkasin departamentit.

Departamenti organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor. Grupi mund të jetë edhe vetëm kërkimor. Kryetarët e grupeve, kur është e mundur, duhet të kenë të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe përzgjidhen me votim nga personeli i departamentit.

Organizimi në grupe mësimore ka për qëllim diskutimin e çështjeve si hartimi i syllabusve, pasurimin e programeve të studimit me lëndë të reja, ndryshime në kurrikul, nevojën për riorganizimin e programeve, kërkesat për stafin akademik për lëndët që mbulon departamenti, dhe çdo çështje tjetër me karakter mësimor që është në kompetencë të departamentit.

Organizimi në grupe të përhershëm ose të përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor ka për qëllim:

- Diskutimin e prioriteteve të kërkimit shkencor
- Promovimin e kërkimit shkencor të stafit akademik të departamentit
- Kordinimin dhe menaxhimin e punës kërkimore shkencore për fushat dhe disiplinat që mbulon secili departament.

Drejtuesi i departamentit thërret mbledhjet e departamentit për diskutimin e çështjeve me karakter mësimor- kërkimor dhe çdo problematikë tjetër. Departamenti mbledhet zakonisht 1 herë në muaj, por në varësi të problematikave mund të mbledhet edhe më shpesh.

Vendimet e të gjitha çështjeve që diskutohen në nivel departamenti merren kur pjesëmarrja është më shumë se 2/3 dhe kur shumica voton pro.

Neni 6

Personeli i Departamentit

Drejtuesi i departamentit është autoriteti drejtues akademik i departamentit, zgjedhja dhe funksionet e të cilit janë të përcaktuara në Statutin e TBU, neni 24. Ai mban përgjegjësi për ndarjen e ngarkesës mësimore ndërmjet anëtarëve të stafit akademik duke respektuar rregullat dhe legjislacionin në fuqi. Ndarja e ngarkesave mësimore përfundon të paktën 1 muaj përpara fillimit të semestrit. Në ndarjen e kësaj ngarkese Drejtuesi i njësisë merr parasysh që stafi akademik të ketë në dispozicion të tij si rregull rreth 30% të kohës në dispozicion për kërkimin shkencor.

Personeli i departamentit përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë, të pjesshme si dhe personeli ndihmës akademik.

Punësimi dhe vlerësimi i personelit akademik të departamentit bëhet në përputhje me Rregulloren për punësimin e personelit akademik. Kohëzgjatja e punësimit dhe kategoritë përbërëse të personelit akademik të secilit departament janë ato të përcaktuara në Statutin e TBU dhe L-AL në fuqi.

KREU III

QENDRA PËR KËRKIME E STUDIME EKONOMIKE E JURIDIKE

Neni 7

Funksionet e Qendrës për kërkime e studime ekonomike dhe juridike

“Qendra për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike” (QKSEJ) është njësi bazë, që funksionon pranë fakultetit të Drejtësisë dhe ka funksionet e mëposhtme:

- Organizon dhe drejton veprimtarinë kërkimore të TBU.
- Bashkëpunon me departamentet e tjera të TBU dhe kontribuon në hartimin e prioriteteve të kërkimit shkencor.
- Kordinon veprimtaritë kërkimore shkencore midis departamenteve të TBU me qëllim organizimin e veprimtarive kërkimore shkencore në nivel institucioni.
- Mbështet realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” të ofruara nga departamentet e tjerë në TBU.
- Mbështet punën kërkimore shkencore të stafit akademik si edhe studentëve të TBU.
- Çdo përgjegjësi dhe / ose kompetencë tjetër e parashikuar Statutin e TBU, akte të tjera rregullatore si edhe L-AL ne fuqi, të aplikueshme në rastin e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.

Neni 8

Organizimi i Qendrës

QKSEJ përbëhet nga Drejtori dhe te pakten 2 anëtarë. Drejtori i QKSEJ gëzon të njëjtat cilësi, mandat dhe kompetenca si drejtuesi i departamentit të aplikueshme në rastin e procesit kërkimor-shkencor dhe emërohet me të njëjtën mënyrë. Përgjegjësitë dhe kompetencat e Drejtorit të QKSEJ janë të përcaktuara në nenin 25 të Statutit të TBU.

KREU IV

Dispozita te fundit

Neni 9

Aprovimi, ndryshimi dhe hyrja në fuqi

Kjo rregullore hartohet nga drejtuesit e njësive kryesore në bashkëpunim me departamentet dhe miratohet nga Senati Akademik. Interpretimi dhe çdo ndryshim i saj është përsëri kompetencë e Senatit Akademik.

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Senati Akademik.